



**Cila është mbrojtja administrative e ofruar nga ILDKPKI, ndaj kërkesave për mbrojtje?**

## **Evidenca mbi tendencat e hakmarrjes ndaj sinjalizuesve**




Nga të dhënat statistikore të administruara për harkun kohor 2017-2022 rezultojnë se ka dy raste ku ndaj sinjalizuesit të një rasti konkret ishin duke u kryer veprime hakmarrëse nga organizata, ku Inspektorati i Lartë i është drejtuar kësaj të fundit për marrjen e masave paraprake.

Procedura e hetimit administrativ për sinjalizimet e jashtme dhe kërkesat për mbrojtje nga hakmarrja konsiston në:

1. regjistrimin e sinjalizimit apo të kërkesës;
2. ftesë për sinjalizuesin për t'u paraqitur në ILDKPKI për të vënë në dispozicion të dhënat dhe dokumentacionin e nevojshëm;
3. ftesë të të sinjalizuarit për t'u paraqitur në ILDKPKI për t'u njohur me rastin e sinjalizuar dhe për të dhënë shpjegime në lidhje me të;
4. kërkesë organizatës për të vënë në dispozicion dokumentacionin e nevojshëm në funksion të hetimit administrativ;
5. evidentimin e proceseve në procesverbalet përkatëse, si dhe vlerësimin në total të të dhënave të administruara;
6. përfundimin e procedurës së hetimit administrativ duke konkluduar me marrjen e vendimeve përkatëse sipas rastit.

### Numri i kërkesave për mbrojtje nga hakmarrja



Në kuadër të trajtimit të kërkesave për mbrojtje nga hakmarrja ndër vite, vlerësohet të përmendet se vetëm dy raste kanë rezultuar të vërteta.

Rastet i përkasin periudhës 2020-2021, dhe pas kryerjes së hetimeve përkatëse, ILDKPKI, ka kërkuar nga autoriteti publik, marrjen e masave për mbrojtjen e sinjalizuesit.

## **KONSTATIME**

*Nga të dhënat cilësore dhe statistikore të mbledhura dhe të përpunuara për periudhën 2017-2022 rezultojnë se ka një raport të drejtë midis numrit të sinjalizimeve dhe rastet e hakmarrjes. Kjo në kuptim të asaj që 9 rastet e hakmarrjes i korrespondojnë një numri të vogël të rasteve të sinjalizimit.*

*Gjithashtu vërehet se kultura e sinjalizimit të korrupsionit dhe praktikave korruptive nuk është mjaft e zhvilluar. Si një ndër faktorët kryesorë mund të evidentojmë frikën nga hakmarrja e eprorëve apo edhe personave të përfshirë në korrupsion.*